



***PYETJET MË TË SHPESHTA LIDHUR ME KËRKESAT E  
LIGJIT TË RI PËR KONTABILITET RAPORTIM  
FINANCIAR DHE AUDITIM***

## Kur ka hyrë në fuqi ligji i ri për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim?

Ligji Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim ka hyrë në fuqi më 1 janar 2019 dhe aplikohet për periudhën raportuese të vitit 2019 e tutje.

## Çfarë ka ndryshuar nga ligji i kaluar?

Me ligjin e ri i cili është në fuqi nga viti 2019 ka ndryshuar klasifikimi i ndërmarrjeve, kërkesat për auditim dhe rishikim, si dhe kërkesat shtesë për raportim për ndërmarrje të mëdha dhe sipërmarrje me interes publik. Gjithashtu ligji i ri parasheh vendosjen e ndëshkimeve për mos respektim të kërkesave ligjore, qoftë nga firma apo nga individët.

## Si klasifikohet ndërmarrja ime?

Ndërmarrja juaj duhet të plotësoj dy nga tri kriteret për tu klasifikuar në një kategori. Kriteret për klasifikim janë: gjithsej qarkullimi vjetor neto; gjithsej pasuritë; si dhe numri mesatarë i të punësuarve gjatë vitit.

Klasifikimi i ndërmarrjeve bëhet mbi bazën e treguesve të përcaktuar në ditën e fundit të vitit të kaluar financiar, për qëllime të përgatitjes së pasqyrave financiare për vitin aktual.

Ju mund të klasifikoni ndërmarrjen tuaj duke përdorur **kalkulatorin e SHKÇAK** duke klikuar **KËTU**.

Gjithashtu mund të klasifikoni ndërmarrjen tuaj duke shfrytëzuar të dhënat nga tabela e mëposhtme:

	Micro ndërmarrje	Ndërmarrje e vogël	Ndërmarrje e mesme	Ndërmarrje e madhe
<b>Totali i qarkullimit vjetor neto</b>	0€ – 700,000€	700,000€ – 8,000,000€	8,000,000€ – 40,000,000€	Mbi 40,000,000€
<b>Totali i pasurisë më 31.12.20XX</b>	0€ – 350,000€	350,000€ – 4,000,000€	4,000,000€ – 20,000,000€	Mbi 20,000,000€
<b>Numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit</b>	0 – 10	10 – 50	50 - 250	Mbi 250

## A ndahen mikro ndërmarrjet në më shumë klasa?

Mikro ndërmarrjet ndahen në tre klasa:

	MIKRO - Klasa I	MIKRO - Klasa II	MIKRO - Klasa III
<b>Totali i qarkullimit vjetor neto</b>	0€ – 50,000€	50,000.01€ – 300,000€	Mbi 300,000€

### Cilat ndërmarrje konsiderohen Sipërmarrje me Interes Publik (SIP)?

Subjektet me interes publik (SIP) – janë:

- institucionet financiare, që i nënshtrohen licencimit nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) në bazë të legjislacionit të fuqi;
- ndërmarrjet publike dhe shoqërore dhe shoqëritë tregtare që i plotësojnë kriteret e për t'u klasifikuar si shoqërive të mëdha tregtare, në përputhje me këtë Ligj;
- subjektet e letrave me vlerë të cilat janë të lejuara për tregtim në një treg të rregulluar në Republikën e Kosovës, sipas legjislacionit në fuqi.

### Ndërmarrja ime klasifikohet si Mikro Ndërmarrje e Klasës I cilat janë kërkesat për raportim?

Mikro ndërmarrjet e **Klasës I** përgatisin pasqyrën e të ardhurave për periudhën raportuese sipas parimit të parasë së gatshme ose parimit aktual të kontabilitetit, në varësi të përzgjedhjes nga vetë ndërmarrja.

### Ndërmarrja ime klasifikohet si Mikro Ndërmarrje e Klasës II cilat janë kërkesat për raportim?

Mikro ndërmarrjet e **Klasës II** përgatisin pasqyrën e pozitës financiare në fund të periudhës raportuese dhe pasqyrën e të ardhurave sipas parimit aktual të kontabilitetit.

### Ndërmarrja ime klasifikohet si Mikro Ndërmarrje e Klasës III cilat janë kërkesat për raportim?

Mikro ndërmarrjet e **Klasës III** përgatisin pasqyrat financiare vjetore të plota në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtarë të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe Mesme (SNRF për NVM-të).

---

## **A duhet të raportoj edhe ndonjë informacion shtesë nëse ndërmarrja ime është Mikro Ndërmarrje e Klasës I, II apo III?**

Po Mikro ndërmarrjet e cilësdo klasë duhet të raportojnë edhe për:

- numrin mesatarë të të punësuarve gjatë periudhës raportuese
- gjithsej pasuritë dhe detyrimet në datën e fundit të periudhës raportuese
- bazën apo parimin mbi të cilën janë përgatitur pasqyrat financiare.

Mikro ndërmarrjet e Klasës II & III, pasqyrave financiare duhet ti bashkëngjisin edhe deklaratën e pajtueshmërisë të nënshkruar nga drejtori ekzekutiv apo pronari dhe zyrtari kryesor financiar apo personi përgjegjës për financa, që deklarojnë se ato pasqyra financiare paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtet në pajtueshmëri me parimet e zbatueshme të kontabilitetit.

## **Cilat janë kërkesat për raportim nëse ndërmarrja ime klasifikohet si ndërmarrje e Vogël apo e Mesme (NVM)?**

Të gjitha NVM-të gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare duhet të zbatojnë Standardin Ndërkombëtarë të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe Mesme (**SNRF për NVM-të**).

## **Ndërmarrja ime është NVM por ka qarkullim vjetor neto nën 4,000,000 Euro a duhet të auditohet apo të rishikohet?**

Të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara si NVM të cilat kanë qarkullim vjetor neto **nën** 4,000,000€ duhet ta angazhojnë një firmë të auditimit apo ndonjë auditor ligjor të licencuar nga KKRF për të kryer rishikimin e pasqyrave financiare vjetore.

## **Ndërmarrja ime është NVM por ka qarkullim vjetor neto mbi 4,000,000 Euro a duhet të auditohet apo të rishikohet?**

Të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara si NVM të cilat kanë qarkullim vjetor neto **mbi** 4,000,000€ duhet ta angazhojnë një firmë të auditimit të licencuar nga KKRF për të kryer auditimin e pasqyrave financiare vjetore.

## **Cilat janë kërkesat për raportim nëse ndërmarrja ime klasifikohet si ndërmarrje e Madhe ?**

Të gjitha ndërmarrjet e MËDHA gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare duhet të zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF/IFRS) dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK/IAS).

## **A duhet të auditohet një ndërmarrje e Madhe?**

Të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara si të MËDHA duhet të angazhojnë një firmë të auditimit të licencuar nga KKRF për të kryer auditimin e pasqyrave financiare vjetore.

---

## **A duhet të raportoj ndonjë informacion shtesë nëse ndërmarrja ime është ndërmarrje e Madhe ose SIP?**

Të gjitha ndërmarrjet e MËDHA dhe subjektet me interes publik (SIP) përpos pasqyrave financiare, duhet të përgatisin në baza vjetore edhe:

- **raportin e menaxhmentit**, i cili duhet të përmbajë një vlerësim të drejtë të zhvillimit dhe performancës së ndërmarrjes, si dhe pozitën e saj, përfshirë këtu edhe rreziqet kryesore dhe pasiguritë që kanë të bëjnë me të,
- **deklaratën e pajtueshmërisë** të nënshkruar nga drejtori ekzekutiv dhe zyrtari kryesor financiar, që pasqyrat financiare paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë, dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me Ligjin.

## **A duhet që një kontabilist të nënshkruaj pasqyrat financiare nëse ndërmarrja ime është Mikro Ndërmarrje, NVM apo Ndërmarrje e Madhe?**

Po, në përjashtim të Mikro Ndërmarrjeve të Klasave I dhe II për të cilat Pasqyrat financiare mund të nënshkruhen vetëm nga drejtori ekzekutiv apo pronari.

Të gjitha ndërmarrjet e tjera pa marrë parasysh klasifikimin duhet që Pasqyrat financiare të nënshkruhen nga drejtori ekzekutiv apo pronari dhe nga drejtori financiar/kontabilisti i çertifikuar. Nëse drejtori financiar apo zyrtari kryesor financiar nuk është i certifikuar si kontabilist, atëherë pasqyrat i nënshkruan edhe kontabilisti i certifikuar emri i të cilit figuron në regjistrin publik të kontabilistëve të certifikuar të publikuar nga Shoqatat e Licencuara të Kontabilitetit nga KKRF.

## **A ekzistojnë shembuj për përgatitjen e Pasqyrave financiare vjetore bazuar në kërkesat ligjore?**

PO, KKRF ka publikuar shtojca për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore për çdo kategori të ndërmarrjeve.

**KËTU** mund ti gjeni shtojcat për përgatitjen e pasqyrave financiare të mikro ndërmarrjeve të Klasës I.

**KËTU** mund ti gjeni shtojcat për përgatitjen e pasqyrave financiare të mikro ndërmarrjeve të Klasës II.

**KËTU** mund ti gjeni shtojcat për përgatitjen e pasqyrave financiare të NVM-ve dhe ndërmarrjeve të Mëdha.

## **Cilat ndërmarrje duhet të dorëzojnë pasqyrat financiare në Këshillin Kosovarë për Raportim Financiar (KKRF) dhe kur është afati i fundit për dorëzim?**

Të gjitha ndërmarrjet pa marrë parasysh klasifikimin duhet të dorëzojnë pasqyrat financiare në KKRF më së largu deri më **30 Prill** të vitit vijues. Nëse Ndërmarrja bënë konsolidim të pasqyrave financiare, atëherë data për dorëzim shtyhet deri më **30 Qershor** të vitit vijues.



---

## **A ndëshkohem nëse nuk dorëzoj fare pasqyrat financiare ose dorëzojë pasqyrat financiare por me vonesë?**

Po, ju ndëshkoheni varësisht nga madhësia e ndërmarrjes tuaj.

Ndëshkimet për mos dorëzim me kohë apo mos dorëzim fare variojnë nga 500€ deri në 20,000€.

## **A do të publikohen pasqyra financiare të ndërmarrjes time nga KKRF?**

Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar do ti bëj publike të gjitha pasqyrat financiare të cilat janë subjekt auditimi, që nënkupton të gjitha ndërmarrjet e MËDHA, si dhe ndërmarrjet e VOGLA dhe MESME me qarkullim vjetor mbi 4,000,000€.

## **Në çfarë afati kohor duhet ti ruaj dokumentet financiare?**

Ditari, libri kryesor dhe librat mbështetëse ruhen për të paktën dhjetë (10) vjet Listat e pagave ruhen në afat të pacaktuar.

Dokumentet kontabël në bazë të të cilave janë mbajtur llogaritë ruhen për të paktën pesë (5) vjet.

Bllloqet e shitjes apo format ndihmëse dhe dokumentacionet e ngjashme, dokumentet që lidhen me veprimtarinë e pagesave ruhen për të paktën tre (3) vjet.

Pasqyrat financiare duhet të ruhen përgjithmonë.

## **Unë jam OJQ a vlej në këto kërkesa për ne?**

Jo, këto kërkesa vlej vetëm për ndërmarrjet e regjistruara në Agjensionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë.

## **A duhet të punësoj një kontabilist me orar të plotë apo firmë të kontabilitetit nëse zyrtari im financiar nuk është kontabilist i çertifikuar?**

Ligji nuk e specifikon nëse duhet patjetër të ketë një kontabilist të çertifikuar të punësuar me orar të plotë në ndërmarrje. Andaj ju mund të kontraktoni një Kontabilist apo firmë të Kontabilitetit për të përgatitur dhe nënshkruar pasqyrat financiare.

## **Ku mund të gjej listën e Kontabilistëve të çertifikuar?**

Listën e Kontabilistëve të çertifikuar anëtarë në ShKÇAK mund ta gjeni **KËTU**

## **Ku mund të gjej listën e Auditorëve ligjorë dhe Firmave të Auditimit?**

Listën e auditorëve ligjor të licencuar nga KKRF mund ta gjeni **KËTU**.

---

Listën e firmave të auditimit të licencuara nga KKRF mund ta gjeni **KËTU**.

## **Unë jam Auditor a mund ti ofroj shërbime të tjera të kontabilitetit ndërmarrjes të cilën e auditoj ?**

Sipas dispozitave në fuqi ekziston një listë e shërbimeve të ndaluara për klientët e auditimit:

- shërbimet tatimore;
- shërbimet që përfshijnë vendimmarrjen;
- mbajtja e kontabilitetit;
- shërbimet e listës së pagave;
- shërbimet lidhur me hartimin/zbatimin e kontrollit të brendshëm, vlerësimin e rrezikut, auditimin e brendshëm;
- shërbimet e vlerësimit, këshillimet e përgjithshme;
- shërbimet e burimeve njerëzore.

***Ky dokument ka për qëllim Informimin mbi Kërkesat e Ligjit Nr. 06/L - 038 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim dhe nuk ka për qëllim interpretimin e çfarëdo dispozite ligjore që përfshihet në Ligj ose në Udhëzime Administrative***